



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA KORÇE**

**SHPALLJE PËR  
RANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË  
KATEGORINË EKZEKUTIVE (Specialist)**

**Lloji i diplomës “Arsimi i lartë”,  
niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”**

Në kushtet kur në përfundim të zhvillimit të procedurës së rekrutimit nga jashtë shërbimit civil, Komisioni i Përhershëm i Pranimit, në bazë të VKM nr. 143, datë 12.3.2014, vendosi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pa asnjë të përzgjedhur Bashkia Korçë në zbatim të nenit 22, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut IV, pika 15 të Vendimit nr. 143, datë 12/03/2014, të Këshillit të Ministrave, rishpall procedurat e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e Prokurimeve,

**Për procedurat e rishpalljes për pranim në shërbimin civil në  
kategorinë ekzekutive, afati i aplikimit është 15 ditë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave: 06.02.2015**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

---

Realizimi i procedurave të prokurimit në përputhje me rregullat dhe afatet ligjore me qëllim që fondet të miratuar të prokurohen në kohën e duhur dhe në mënyrë transparente

## I- Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive

---

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë “Master Shkencor” (Arsimi i lartë)

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

- c) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

- d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- dh) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

- e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen nëpërmjet shërbimit postar ose dorazi në Institucionin e Bashkise Korçë

***Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me postë ose në institucion duhet të bëhet brenda datës 06.02.2015***

### **Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e prokurimeve publike;
- Njohuritë mbi Ligjin 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
- Njohuritë mbi Ligjin 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Korçë, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Korçë duke filluar nga data 13.02.2015